

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MJ GROUP” shpk

EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

EMERTIMI

NENI 1

Sot, me 02.11.2020, bazuar ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenshkrimin e Aktit te Themelmit, ne,

• **Z. Marin Shpata**, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 26.02.1983, rezident ne Tirane, Rruga Budi, 2, Vila nr.8, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 032771203/numer personal I30226131V,

• **Znj. Julinda Lutovac**, qytetare shqiptare, lindur ne Tirane, me 21.01.1981, rezidente ne Tirane, rruga Ali Kelmendi, P.49, Ap. 19/3, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pashaportes nr. BG4390010/numer personal I25121053C,

kemi vendosur krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “MJ GROUP” shpk (ne vijim te quajtur “Shoqeria”) dhe hartojme statutin e shoqerise si me poshte vijon:

EMERTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

EMERTIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e quajtur “**MJ GROUP**” shpk.

Shoqeria do ti nenshtrohet ketij statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare “MJ GROUP” sh.p.k do te jete ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.10, Rruga e Kavajes, Godina nr.123.

Shoqeria, mund te vendose transferimin e selise ne nje vend tjeter, te hape vendqendrim te tjera te dyta, dege, agjensi, filiale, perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente, edhe jashte vendit.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria do te kete objekt veprimtarie:

- shitje te produkteve te markes tregtare fast food Proper Pizza, sherbim ne vend (pa perfshire delivery/ shperndarje);
- bar, kafe;
- administrim personeli, sherbime suporti dhe konsulence per bizneset;
- organizim, prodhim dhe xhirim evente;
- prodhim reklama TV, filma, video, auodio, realizim videoklipe;
- dhenie, marrje me qera pajisje ndricimi dhe xhirimi.

Shoqeria, brenda kufijve ligjore, mund te kryeje çdo operacion qe lidhet me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, mund te kryeje operacione industriale dhe tregtare te nevojshme apo te dobishme per realizimin e qellimeve te saj, mund te marre pjese drejtperdrejt ose indirekt ne pjesemarrje ne shoqeri ose subjekte te tjera ne Shqiperi ose jashte saj, te cilat kane objekt te njejte ose te ngjashem ose te lidhur me te vetin, pa e ushtruar kete aktivitet ndaj publikut.

Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te kryhen brenda limiteve ose ne perputhje me normat qe rregullojne aktivitetin.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria mund te hape njesi te dyta, perpunimi, sherbimi tregetimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte e pakufizuar.

Shoqeria mund te priset me vendim te Asamblese se Ortakeve apo ne baze te dispozitave te ligjit te zbatueshem.

KAPITALI SHOQERISE, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6


Kapitali fillestar i shoqerise tregtare **"MJ GROUP" shpk** do te jete i barabarte me Leke 100.000(njeqind mije) dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise.

Kapitali themeltar ndahet ne 2(dy) kuota, me vlere nominale 50.000(pesedhjetete mije) leke secila.

KONTRIBUTET DHE KUOTAT

NENI 7

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:



- **Z. Marin Shpata**, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 26.02.1983, rezident ne Tirane, Rruga Budi, 2, Vila nr.8, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 032771203/numer personal I30226131V, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 50.000(pesedhjete mije) leke;
- **Znj. Julinda Lutovac**, qytetare shqiptare, lindur ne Tirane, me 21.01.1981, rezidente ne Tirane, rruga Ali Kelmendi, P.49, Ap. 19/3, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pashaportes nr. BG4390010/numer personal I25121053C, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 50.000(pesedhjete mije) leke.

Sipas kontributeve te mesiperme:

- **Z. Marin Shpata**, i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon 50% (pesedhjete per qind) te kuotave te kapitalit te Shoqerise;
- **Znj. Julinda Lutovac**, i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon 50% (pesedhjete per qind) te kuotave te kapitalit te Shoqerise.

NENI 8

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen kufirin minimal qe lejon ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme Ortakeve, me $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem.

Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve sipas shumave te percaktuara ne vendimin e Asamblese se Ortakeve.

NENI 9

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise
- shitblerjes
- trashegimise
- dhurimit
- cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Ne rast transferimi te kuotave te kapitalit ne cdo lloj forme personave te trete, me apo pa shperblim, me cdo kusht, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes mbi keto kuota. Ne kete rast ortaku qe do te transferoje kuotat e tij te kapitalit duhet t'i njoftoje ortaket e tjere, me leter te porositur, mbi synimin per shitjen duke specifikuar:(a) sasine kuotave te vena per shitje (b)cmimin e kerkuar, (c) kushtet, modalitetet dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet te gjitha kuotave te kapitalit te ofruar per shitje.

Ortaket duhet te kene ne dispozicion 30 (tridhjete) dite nga marrja e letres se porositur, per ti komunikuar me shkrim, ortakut qe transferon kuotat e kapitalit, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes. Ne asnje rast kushtet e ofruara te treteve, mund te jene me te favorshme nga ato te ofruara ortakeve.

Ne rast se oferta pranohet vetem nga disa ortake, pjeset e kapitalit te ofruara nga ortaku qe transferon pjeset e kapitalit, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejten mase me kuotat qe ata zoterojne, pervec rastit kur ka nje marreveshje te

kundert. Ne asnje rast, ofertuesi do te jete i detyruar te pranoje nje ushtrim vetem pjesor te se drejtes se parablerjes.

Ne rastin e mungeses se ushtrimit te te drejtes se parablerjes, gjithmone ortakeve u rezervohet e drejta e dhenies se pelqimit per ortaket e rinj. Nese ortaket e shoqerise nuk japin pelqimin e tyre per ortaket e rinj kuotat e kapitalit mund t'u transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve. Nuk lejohet te behet asnje akt juridik, perfshire ketu pengun ose uzufuktin, qe mund te coje ne percaktimin, ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte, te transferimit te te drejtave te votes qe lidhen me kuotat e Shoqerise, ne kundershtrim me dispozitat e ketij neni. Ne rast se te drejtat e parablerjes apo te pelqimit paraprak te pershkruara me siper, nuk ushtruhet, te gjitha ortaket e tjere kane te drejte te konkurrojne proporcionalisht, sebashku me ortakun qe shet dhe me te njejtat kushte, ne shitjen e kuotave te treteve.

ORGANET E SHOQERISE

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 10

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, apo te perfaqesohet nga nje person tjetër ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te jape voten e tij. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme. Ortaku nuk mund te jape asnje prokure vote per nje pjese te kapitalit te tij, nese voton personalisht per pjesen tjetër te mbetur.

Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 5% (pese per qind) te kapitalit themeltar. Ne cdo rast, Asambleja thirret te pakten nje here ne vit, por jo me vone se data 30 qershor e vitit pasardhes per te diskutuar dhe miratuar Bilancin vjetor dhe raportet e ecurise se veprimtarise.

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese, leter te porositur, faks apo postes elektronike, menyra keto qe sigurojne percaktimin e dates se njoftimit. Ky njoftim duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjitha ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Asambleja do te konsiderohet rregullisht e thirrur, edhe duke mos respektuar formalitetet e thirrjes, nese eshte pranishem ose i perfaqesuar i gjitha kapitali i shoqerise, dhe kur te gjitha ortaket e pranishem ose te te perfaqesuar ne Asamble jane dakord te mbajne mbledhjen, ne mungese te formaliteteve te thirrjes.

Asambleja mund të mbahet ne videokonference duke parashikuar qe pjesemarrësit jane ne me shume se nje vend, afer apo larg, te lidhur nepermjet audio/video. Per kete qellim eshte e nevojshme qe te plotesohen kerkesat e meposhtme:

- a) ne njoftimin e thirrjes se Asamblese (duke perjashtuar ate totalitare) duhet te specifikohen vendet video/audio te lidhura me vendin ku do te jete Presidenti dhe sekretari;
- b) Presidenti i Asamblese dhe sekretari janë të pranishëm në të njëjtin vend;
- c) Presidenti i Asamblese eshte ne gjendje te konstatoje identitetin dhe legjitimitetin e pjesemarrësve, te rregulloje proceduren e takimit, te konstatoje dhe te shpalle rezultatet e votimit;
- d) duhet te respektohet metoda kolegjinale dhe parimi i trajtimit te barabarte mes te pranishmeve;

- e) personi qe verbalizon duhet te jete ne gjendje te perceptoje ne menyre te pershtatshme mbarevejtjen dhe ngjarjet ne Asamble qe duhen verbalizuar;
- f) te pranishmit duhet te jene ne gjendje te marrin pjese ne diskutim dhe te votojne njekohesisht per argumentet ne rendin e dites.

Keto kushte duhet te paraqiten ne procesverbalin e Asamblese.

Te gjitha vendimet e Asamblese se Ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te Asamblese. Procesverbali duhet te permbaje daten, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te sekretarit te mbledhjes si dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve, si edhe akti i thirrjes se Asamblese. Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga sekretari. Nese shoqeria ka nje faqe te saj te publikuar ne internet, administratoret, jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes, jane te detyruar te publikojne kopje të procesverbalit te mbledhjes se Asamblese.

Neni 11

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, jane te vlefshme nese jane te pranishem, ose te perfaqesuar ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne te pakten 50%+1(pesedhete per qind+1) te te gjithë kapitalit te shoqerise. Ne rast mungese te ketij kuorumi ne mbledhjen e pare, Asambleja thirret ne mbledhjen e dyte, me te njejtin rend dite jo me vone se 30 (tridhjetë) dite pas mbledhjes se pare. Ne thirrjen e dyte, vendimet e Asamblese se Pergjithshme, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, jane te vlefshme nese jane te pranishem, ose te perfaqesuar ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne jo me pak se 30%(tridhjetë per qind) te te gjithë kapitalit te shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendos me shumice te kualifikuar te $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e votave te ortakeve pjesmarres, ose te perfaqesuar qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit te shoqerise, per:

- ndryshimin e statutit,
- zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- shperndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Kuorumi i lartpermendur per vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme, eshte i vlefshem edhe ne thirrjen e dyte.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj, vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara me ligj ose ne kete statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.

ADMINISTRIMI

NENI 12

Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te Shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 5(pese) vjet, me te drejte riparteritjeje.

Te drejtat dhe detyrimet e Administratorve jane si me poshte vijon:

- a) te kryejne te gjitha veprimet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te administrimit, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme, brenda kopetencave qe u jep ligji dhe ky statut;

- b) te perfaqesojne ligjerisht Shoqerine para paleve te treta;
- c) te kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- d) te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) te raportojne perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- f) te kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj.
- g) te emerojne perfaqesauet te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh, sipas udhezimeve te ortakeve.

Administratoret, gjate kryerjes se detyrave te tyre, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratoret veprojne ne kundershtrim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, ata jane te detyruar t'i demshperblejne shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratoret ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Asnje marreveshje mes ortakeve mund te perjashtoje apo te kufizojte kete te drejte.

Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Shperblimet e administratoreve percaktohen me kuorum te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme.

Administrator i shoqerise emerohet znj. Julinda Lutovac nga 02.11.2020 deri me 31.12.2024.

MARREDHENIET EKONOMIKO – FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 13

E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 14

I gjithë dokumentacioni financiar i shoqerise, qe perdoret per te hartuar bilancin vjetor brenda dates 31 mars te cdo viti depozitohet prane selise se Shoqerise.

NENI 15

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor pervec vitit te pare te ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise.

NENI 16

Nga fitimet pas tatimit, te realizuara gjate vitit financiar paraardhes, Shoqeria duhet te kaloje ne "Rezerve Ligjore" te pakten 5% te te kesaj vlere derisa kjo rezerve te arrije ne masen 10% te kapitalit themeltar.

Fitimi neto, pas vecimit te fondeve te permendura me siper, i mbetet ne perdorim ortakeve te shoqerise, te cilet nepermjet Asamblese se Pergjithshme vendosin destinacionin e tij, ta shperndajne apo ta riinvestojne ne shoqeri.

NENI 17

Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Pergjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet 1(nje) eksperti kontabel te autorizuar.

Eksperti kontabel i autorizuar do te jete ne detyre per nje periudhe ushtrimore dhe do te mbaroje mandatin e tij ne daten e Asamblese se mbledhur per miratimin e bilancit te ketij viti ushtrimor, me te drejte rizgjedhje.

Eksperti kontabel i autorizuar mund te revokohet ne cdo moment sipas normave te legjislacionit ne fuqi.

SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 18

Shnderrimi i shoqerise "MJ GROUP" sh.p.k. ne Sh.A., mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme me shumice te kualifikuar.

NENI 19

Shperberja e Shoqerise, mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si:

- humbja e kapitalit te shoqerise,
- pamundesi veprimi,
- me vendim te Asamblese se Pergjithshme,
- me hapjen e procedurave te falimentimit,
- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- me vendim te gjykates,
- per arsye te tjera te parashikuarane ligj dhe/ose ne kete Statut.

Ne rastet e shperberjes se Shoqerise per arsye te ndryshme nga ajo e falimentimit apo e vendimit te gjykates, Asambleja e Pergjithshme vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore duke u percaktuar ayre edhe detyrat; keta te fundit raportojne ne Asamblene e Pergjithshme mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te Shoqerise, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohet e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

Gjate procedurave se likujdimit, administratoret duhet te kufizohen ne veprimtarine e tyre ne aktet qe jane te nevojshme gjate kesaj faze dhe qe per natyren e tyre nuk hyjne ne kopetencat e likujdatoreve.

Me perfundimin e procedurave te likujdimit, Asambleja e Pergjithshme vendos mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likujdatoret dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit.

Pas pagimit te detyrimeve ndaj paleve te treta, arketimit te kredive, te ardhurat perfundimtare do tu ndahen ortakeve ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

NENI 20

Te gjitha mosmarreveshjet mes paleve qe mund te lindin ose qe lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti, si dhe ne pergjithesi cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis ortakeve ose midis nje apo disa ortakeve me shoqerine, do te zgjidhen me mirekuptim midis paleve me diskutim te drejtperdrejte midis te interesuarve.

Nese nuk arrihet qe nje mosmarreveshje te zgjidhet me mirekuptim, atehere zgjidhja do ti kerkohet eskuzivisht Gjykates se rrethit te Tiranes.


DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 21

Ky statut perpilohet dhe nenshkruhet ne 2(dy) kopje ne gjuhen shqipe per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare "MJ GROUP" shpk.

ORTAKET

Z. Marin Shpata

MARIN SHPATA


Znj. Julinda Lutovac

Julinda Lutovac
